



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr. ____ Prot

Datë ____ / ____ / 2022

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 shpall 1 vend vakant për pozicionin e punës: **Përgjegjës/e e Bibliotekës Muzikore pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë.**

Kandidatët për pozicionin e punës duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:

1. Të ketë mbaruar studimet në Universitetin e Arteve në një nga degët e fakultetit të muzikës;
2. Të jetë njohës i programeve bazë të kompjuterit;
3. Të jetë njohës i një prej programeve muzikore kompjuterik (Sibelius, Finale, Dorico etj.);
4. Të dijë të lexojë partiturë dirigjenti, klavir, parte orkestre etj;
5. Të jetë njohës i çelësave të instrumentëve me transport;
6. Të ketë njohuri bazë të gjuhës italiane dhe angleze;
7. Preferohet të ketë eksperiencë pune në institucione të kulturës;
8. Të ketë aftësi të organizojë punën duke përmbushur afatet;
9. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

1. Jetëshkrimi CV;
2. Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara.
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë së TKOBAP(zyra e protokollit) ose të skanuara në mailin zyrtar të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri me datë 30.09.2022. Pas verifikimit të dokumentave të kërkuara, në Teatrin Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara do të lajmërohen nepërmjet numrit të tyre të kontaktit ose mail nga Sekretaria e Institucionit, për intervistën e strukturuar me gojë.

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të web-it të Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor www.tkob.gov.al; faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al.

DREJTORE e PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA